



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 383 Prot.

Tiranë, më datë 06.082018

VENDIM

Nr. 320, datë 27.07.2018

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT ZHVILLIMOR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48, pika 1 dhe neni 134, pika 1, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 27.07.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin projektit me objekt: “Ndërtimi i burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit “Vardari”, në përroin e Vardarit dhe të Valit, degë e përroit të Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan”, kërkesë e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k.;
– *Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture: “Shaqir Ballës, në fshatin Kostenjë, Librazhd”;*
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 134, pika 2;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Mirela KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

Daniel Pirushi